VENDIM
Nr. 845, datë 5.11.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 7.2.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... 20 480 (njëzet mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... 21 074 (njëzet e një mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj ...".

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2027.

KRYEMINISTËR
Edi Rama